



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Mbështetur në nenin 16, paragrafi 1, shkronja **b** dhe nenin 32.1 shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.9.2008, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E FUSHËS SPORTIVE NË
LAGJEN "ARBËRIA 2" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës sportive në lagjen "Arbëria 2" në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas neni 1 të këtij Vendimi, përfshin pjesën e ngastrës kadastrore nr. 2987/1, Zona Kadastrore Prishtinë, në një sipërfaqe prej 50.0 arë e evidencuar si pasuri shoqërore e Hortikulturës.

Neni 3

Lokacioni i cekur nën nenin 2 të këtij Vendimi do të përdoret për të ndërtuar terrenin sportiv pa objekte tjera përcjellëse.

Neni 4

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të terrenit të hapur sportiv, për të cilin është caktuar lokacionin sipas këtij Vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, do të kryejë veprime nga përgjegjësia e vet e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 35-1326, dt.11.9.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof dr. Isa Mustafa